



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Komisioni për emërtimin e Objekteve Publike
Nr.01-060/01-30364/24 datë:20.11.2024



Npi – 01/367 datë: 22.11.2024

Komisioni për emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes, duke u bazuar në Ligjin për sistemin e adresave, Nr.04-L-071: Udhëzimin Administrativ të MMPH, Nr.14 /2019 për caktimin e emërimit dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira; Si dhe bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/287 datë: 30.08.2024 për zgjedhjen komisionit për emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 22.11.2024 miratoi këtë:

KONKLUZION

PËR NJOFTIMIN E QYTETARËVE TË KOMUNËS SË SHITES, LIDHUR ME PARASHTRIMIN E PROPOZIMEVE PËR EMËRTIMIN E OBJEKTEVE PUBLIKE

I

Komisioni për Emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes, në mbledhjen e -II- për vitin 2024 të mbajtur më datën 22.11.2024, unanimisht miratoi Konkluzionin që, të njoftohen qytetarët e Komunës së Shtimes, përmes Zyrës për Informim, për mundësinë e parashtrimit të propozimeve për emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes, në afat prej 30 dite nga dita e publikimit të Njoftimit.

II

Propozimet e dhëna duhet ti plotësojnë kriteret ligjore, duke i bashkëngjitur edhe historikun e personalitetit i cili propozohet mbi bazën e kontributit të dhënë për Komunën e Shtimes ose më gjerë, duke qenë adekuate me fushën e objektit (institucionit) i cili emërtohet. Propozimet për emërtimin e objekteve, dorëzohen në Zyrën Pritëse, kati përdhësë.

II

Konkluzioni u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Komisionit
Ruzhdi Jashari